



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 21.09.2022, merr këtë

V E N D I M
PËR FINANCIMIN E SHUJTAVE DITORE PËR SHËRBYESIT CIVILË TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

I.

MIRATOHET Vendimi për realizimin e shujtave ditore për shërbyesit civilë të Komunës së Prishtinës.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 5 € në ditë, për secilin punonjës të administratës komunale, e siguruar nga kategoria " Paga dhe shtesa ".

III.

Qëllimi i këtij vendimi është realizimi i shujtave, në vlerë prej 5 € në ditë, në mënyrë retroaktive, për vitin 2022, për të gjithë të punonjësit e administratës komunale në Prishtinë.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-110/01-206963/22, më 26.09.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

